



Dr. Urzimit.
Per opojenjen teknike.



Nr. 2040 prot.
12/06/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Nr. 605/Prot.
12

Tiranë, më 11 06 .2024

Lënda: **Dërgim Oponence Teknike**

BASHKISË BELSH

Belsh

Në vijim të kërkesës suaj me Nr.1459 prot, datë. 18.04.2024 , protokolluar me tonën me Nr.605 prot, datë.22.04.2024 “**Kërkesë për kryerjen e Oponencës teknike**”, po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të projekt zbatimit me objekt: “**Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i rrugëve të brendshme**“, Bashkia Belsh.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Artan SHKRELI

OPONENCË TEKNIKE
PËR PROJEKTIN E ZBATIMIT TË OBJEKTIT
“NDËRTIM, SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËVE TË
BRENDSHME, BASHKIA BELSH”

POROSITËS: BASHKIA BELSH

PROJEKTUES: SHOQËRIA “ZETAKONSULT” SHPK

GRUPI I PROJEKTIMIT :

- | | |
|---------------------|--------------------|
| - Ing. Flutura DURO | Inxhinier Ndërtimi |
| - Ing. Lorenc HOXHA | Inxhinier Ndërtimi |
| - Ing. Luan BREGU | Inxhinier Topograf |

Bëhet kjo Oponence Teknike për Projektin e Zbatimit të objektit “NDËRTIM, SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËVE TË BRENDSHME, BASHKIA BELSH”, mbështetur në Ligjin Nr. 8402 dt.10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Neni 6; në V.K.M. Nr.9 dt.11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë , si dhe procedurat që duhet të ndiqen në këto raste”, në Urdhërin e Ministrit Nr.243 dt. 12.06.2019 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe në Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Grupit të oponencës, i janë vënë në dispozicion këto materiale:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike Nr. Prot. 1459 Datë 18.04.2024 të Bashkia Belsh protokolluar me tonën me Nr. Prot. 605, Datë 22.04.2024.
- Marrëveshja midis Bashkisë Belsh dhe Institutit të Ndërtimit me Nr. 16-7 Prot, date. 07.05.2024 dhe me Nr.605/1 prot, date.02.05.2024 e Institutit të Ndërtimit, ku Tarifa e shërbimit për kryerjen e oponencës teknike është **28,027** (njëzet e tetë mijë e njëzet e shtatë) lekë me TVSH.
- Detyra e Projektimit
- Raport Teknik
- Raport Topografik



- Relacion për Llogaritjen e shtresave rrugore
- Projekt rrugëve
- Profili Gjatësor
- Profili Tërthor
- Profili Tip
- Preventiv
- Grafiku i punimeve
- Specifikime teknike
- Tabela e Volumeve
- CD

Mangësi të materialeve për kryerjen e Oponencës Teknike:

- Kontrata e shërbimit
- Raport Gjeologjik
- License e grupit të projektimit
- VNM
- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale

Materiali i dorëzuar, do të konsiderohet i mirëqenë dhe i saktë nga ana ligjore, absolutisht në përgjegjësi të dorëzuesit dhe do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit dhe hartimin e Oponencës Teknike.

1. DETYRË PROJEKTIMI

Detyra e projektimit është paraqitur në 9 fletë formati A4, hartuar nga Ndrim Reka dhe miratuar nga Kryetari Z.Arif TAFANI. Objekti “Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i Rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh”, ndodhet në Qarkun e Elbasanit, në territorin e Bashkisë Belsh, në njësitë administrative Belsh dhe Kajan. Objektivi është sistemimi dhe asfaltimi i segmenteve rrugore:

1. Rikonstruksioni i rrugës Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
2. Rikonstruksion i rrugës Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh
3. Rikonstruksion i rrugës Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
4. Rikonstruksion i rrugës Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
5. Rikonstruksion i rrugës Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh

Gjendja ekzistuese është e degraduar dhe parashikohet ndërtimi i rrugës me gjerësi asfaltike 2.5 - 4 m dhe trup rruge me gjerësi 4.5-6 m sipas tipologjisë së rrugës.

Projekti duhet të përmbajë:

- Azhornimin Topografik te Terrenit;
- Planvendosja dhe planimetria e rrugës, profilet tërthore dhe gjatësore në shkallën 1 :2500 në formatin A3 dhe A2, me të gjitha koeficientet e treguesit të zhvillimit në përputhje me ligjin Nr. 107/2014, date.3 1.07.2017. VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 si dhe PPV-në Belsh për të bërë të mundur kërkesen e përputhshmërisë së projekt zbatimit si dhe aplikimin për leje ndërtimi në portalin e-leje;
- Projekti Teknik
- Relacioni
- Grafikun e Punimeve te detajuar sipas zërave të punës;
- Preventivin e Punimeve;
- Raporti Paraprak i VNM-se;
- Studimi gjeologjik
- Studimi sizmik
- Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren.

2. RAPORT TEKNIK

Raporti teknik është paraqitur në 17 fletë formati A4. Objekti : “Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i Rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh”, ndodhet në Qarkun e Elbasanit, në territorin e Bashkisë Belsh, në njësite administrative Belsh dhe Kajan. Këto segmente rrugore, ndodhen në gjendje teje të amortizuar, nuk ka shtresa asfaltike, përgjatë rrugës ka patur nderhyrje ne vepra arti kryesisht tombno, Segmentet rrugore, që bëjnë pjesë janë:

1. Rikonstrukcioni i rrugës Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
2. Rikonstrukcion i rrugës Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh
3. Rikonstrukcion i rrugës Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
4. Rikonstrukcion i rrugës Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
5. Rikonstrukcion i rrugës Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh

Konkluzion:

- **Raporti Teknik duhet të ishte më i plotë, duhet të shoqërohet me fotot përkatëse për secilin segment si dhe të paraqiten elementet gjeometrikë dhe të përshkruhen ndërhyrjet që**



do të bëhen për secilin segment. Të plotësohet.

- Në preventiv është paraqitur zëri: Tombino tuba betoni Ø400 dhe Ø600. Të evidentohen në RT se ku do të realizohen. Të plotësohet.

3. RAPORTI TOPOGRAFIK

Studimi Topografik është paraqitur në 3 fletë formati A4. Konsulenti ka dhënë një përshkrim të zonës ku ndodhet objekti. Në relacion është përshkruar puna e bërë për krijimin e një rrjeti mbështetës për projektin. Për projektimin e rrjetit u shfrytëzuan materiale hartografike si hartat topografike ushtarake 1:25 000 dhe ortofoto 2015.

Për realizimin e punimeve topo-gjeodezike në këtë segment rrugore është përdorur marrës GPS SOKKIA GRX2.

Cdo pike e rrjetit gjeodezik të ndertuar është shoqëruar me monografine e saj, e cila jep informacion për vendndodhjen gjeografike të pikës, numrin dhe koordinatat e saj në sistemin shtetëror.

Konkluzion:

- **Relacioni Topografik duhet të jetë me i plotë, duhet të shoqërohet me foto të realizuara gjatë punimeve si dhe të paraqiten koordinatat përkatëse.**

4. LLOGARITJA E SHTRESAVE RRUGORE

Raporti i llogaritjes së shtresave rrugore është paraqitur në 3 faqe A4. Konsulenti për këtë raport është bazuar në :

□ “AASHTO Guide for Design of pavement Structures 1993”

Kjo metodë (AASHTO) bazohet në këto 4 faktorë që konsistojnë në këto pika :

- 1 Trafiku i projekimit
- 2 Koeficienti i besueshmërisë së procesit të dimensionimit;
- 3 Karakteristikat e shtresave (numri struktural SN).
- 4 Kufiri i pranueshëm i degradimit të mbistrukturës;

Kjo metodë është bazuar në këto të dhëna:

1. Intensiteti I trafikut per peridhen 15 vjecare
2. Besueshmeria: **95%**
3. Devijimi i pergjithshem standart **$S_0=0.44$**
4. Moduli resilent i tabaneve **$Mr=35 \text{ Mpa}$ (CBR 2 deri 4%)**
5. Humbja e sherbimit te projektimit **$\Delta PSI=3$**

Ngarkesa e trafikut me aks standart jetegjatesine 15vjecare, $\dot{E}18 - 0.4 \times 10^6$

Duke marrë të dhënat e mësipërme, konsulenti ka arritur në këtë paketë shtresash:

- Paketa e asfaltit



- Asfaltobeton 4 cm;
- Binder 6 cm;
- Stabilizant 10 cm;
- Shtresë Çakëll 20 cm;

Kjo është paketa e shtresave por në këtë fazë të projektit do të realizohet vetëm kjo paketë:

- Binder 6 cm;
- Stabilizant 10 cm;
- Shtresë Çakëll 20 cm;

Konkluzion:

- Llogaritja e shtresave rrugore është bërë sipas metodës “AASHTO Guide for Design of Pavement Structures”.
- Mendojmë që janë argumentuar të gjitha pikat ku janë mbështetur për të përzgjedhur paketën e shtresave, por të plotësohet me pjesën grafike e cila nuk është paraqitur. Të bëhen plotësimet përkatëse.
- Gjate realizimit të projektit duhet të zbatohen me rigorozitetet specifikimet teknike të paketës asfaltike nga kompania që do të zbatojë punimet rrugore.

5. PARAQITJA GRAFIKE E PROJEKTIT

5.1 HOROGRAFIA

Horografia është paraqitur në 5 fletë formati A3, në shkallën 1:1000. Horografia është paraqitur për këto segmente rrugore:

- Rruga Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
- Rruga Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh
- Rruga Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
- Rruga Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
- Rruga Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh



Konkluzion:

- Horografia mund të ishte më e plotë duke paraqitur koordinatat e fillimit dhe mbarimit si dhe orientimin gjeografik.

5.2 PLANIMETRIA

Planimetria e përgjithshme është paraqitur në 18 fletë formati A3 në shkallën 1:500. Janë paraqitur planimetritë për rrugët:

- Rruga Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
- Rruga Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh



- Rruga Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
 - Rruga Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
 - Rruga Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh
- Planimetritë e paraqitura janë të qarta si dhe janë paraqitur piketat çdo 25m.

Konkluzion:

- **Planimetritë nuk janë të plota.**
- **Planimetritë duhet të plotësohen me elementë gjeometrikë si dhe të përcaktohen në planimetri se ku do të vendosen tombinot.**

5.3 PROFILI GJATËSOR

Profili gjatësor është paraqitur në 11 fletë formati A3 në shkallë Horizontale 1:1000 dhe shkallë vertikale 1:1000. Profilet gjatësore janë paraqitur për:

- Rruga Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
- Rruga Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh
- Rruga Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
- Rruga Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
- Rruga Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh

Në secilin profil gjatësor janë hedhur këto të dhëna:

- Nr. prerjes
- Distanca pjesore
- Distanca progresive
- Kuota toke
- Kuota projektit
- Kuota punës
- Gjeometria Horizontale
- Gjeometria Vertikale
- Kilometrazhi

Konkluzion:

- **Profili gjatësor është paraqitur konform kushteve teknike të projektimit.**

5.4 PROFILAT TËRTHORE

Seksionet tërthorë janë paraqitur në 38 fletë formati A3 në shkallën 1:200. Profilet tërthorë janë paraqitur për:

- Rruga Shkëndi L=650 ml, fshati Shkendi, Nj.A. Belsh
- Rruga Shkoze L=700ml, fshati Shkoze, Nj.A. Belsh
- Rruga Idriz L=1000ml, fshati Drizaj, Nj.A. Kajan
- Rruga Turbull L=492ml, fshati Turbull, Nj.A. Kajan
- Rruga Seferan L=560ml, fshati Seferan, Nj.A. Belsh

Profilet tërthore janë hartuar duke përcaktuar qartë të dhënat mbi:



- Kuota terrenit
- Distanca
- Kuota projektit
- Distanca
- Kuota punes

Janë paraqitur për secilin profil sipërfaqja dhe volumi i gërmimeve, mbushjeve si dhe paketa e shtresave trup rruge.

Konkluzion:

- **Profilat tërthore janë paraqitur konform kushteve teknike të projektimit.**

5.5 PROFILI TËRTHOR TIP

Profili tip është paraqitur në 3 fletë formati A3. Në këtë profil tip janë përcaktuar shtresat rrugore të trupit të rrugës dhe pjerrësia tërthore e rrugës.

🚧 Profili tërthor tip Seg. Idriz

- Korsi kalimi (1x4.0m)
- Bankinë në të dy anët (2x0.75m)
- Trupi I rrugës (5.5) m

● **Shtresat për rrugën janë:**

- Binder 6cm
- Stabilizant 15cm
- Shtresë cakëll 20cm
- Tokë natyrale

🚧 Profili tërthor tip Seg. Shkozë

- Korsi kalimi (1x3.0m)
- Bankinë në të dy anët (2x0.75m)
- Trupi I rrugës (4.5) m

● **Shtresat për rrugën janë:**

- Binder 6cm
- Stabilizant 15cm
- Shtresë cakëll 20cm
- Tokë natyrale

🚧 Profili tërthor tip Seg. Shkëndi

- Korsi kalimi (1x3.0m)
- Bankinë në të dy anët (2x0.75m)
- Trupi I rrugës (4.5) m

● **Shtresat për rrugën janë:**



- Binder 6cm
- Stabilizant 15cm
- Shtresë cakëll 20cm
- Tokë natyrale

✚ **Profili tërthor tip Seg. Turbull**

- Korsi kalimi (1x3.0m)
- Bankinë në të dy anët (2x0.75m)
- Trupi I rrugës (4.5) m

● **Shtresat për rrugën janë:**

- Binder 6cm
- Stabilizant 15cm
- Shtresë cakëll 20cm
- Tokë natyrale

✚ **Profili tërthor tip Seg. Seferan**

- Korsi kalimi (1x3.0m)
- Bankinë në të dy anët (2x0.5m)
- Trupi I rrugës (4.0) m

● **Shtresat për rrugën janë:**

- Binder 6cm
- Stabilizant 15cm
- Shtresë cakëll 20cm
- Tokë natyrale

Konkluzion:

- **Profilat tërthorë tip janë paraqitur konform kushteve të projektimit.**
- **Ato janë paraqitur sipas relacionit llogaritës së shtresave.**

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Ato janë ndarë në kapituj si më poshtë:

- TE PERGJITHSHME DHE PARAPRAKE
- CILESIA DHE BURIMET E MATERIALEVE
- TESTIMI I MATERIALEVE
- PUNIMET E DHEUT
- PUNIMET E SHTRESAVE
- BETONET
- PUNIMET E PRISHJEVE



- PUNIME PER RRJETIN E KUB
- BETONI PER PUTHITJET, LIDHJET E KENDEVE, PJESET SPECIALE, PARAPETI,
- KALLEPET, PUNIMET E FSHEHURA DHE FIKSIMET
- MURET E BUTO-BETONIT
- TOMBINOT RRETHORE
- FUGAT E DEFORMIMIT
- SHTRIMI (ASFALTIMI) I RRUGEVE
- ELEMENTET PREJ BETONI TE PARAFABRIKUAR
- PUNIMET E DRENAZHIT
- PARMAKET E ÇELIKUT DHE PARAPETET METALIKE
- PUNIMET E ELEKTRIKUT
- SINJALISTIKE RRUGORE

Konkluzion:

- **Specifikimet teknike janë të plota.**

7. PREVENTIVI

Preventivi për objektin “NDËRTIM, SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËVE TË BRENDSHME, BASHKIA BELSH” është paraqitur në 6 fletë A4.

Preventivi është i ndarë sipas kapitujve të mëposhtëm:

- **PUNIME GËRMIMI**
- **PUNIME SHITESASH**
- **PUNIME ASFALTIMI**
- **PUNIME BETONI E BETONARMEJE**
- **NDËRTIMI I VEPRAVE TË ARTIT+KANALIZIME**

Vlera Totale e punimeve të preventivuara është **54,418,711.87 LEK** përfshirë TVSH 20%.



Konkluzion:

- **Në preventiv, numrat e analizave dhe çmimet respective për secilin zë punimesh janë marrë në përputhje me VKM Nr.216, dt. 13.04.2023 në fuqi në vendin tonë.**
 - **Përgjegjësia për çmimet e marra është e preventivuesit.**
 - **Në preventiv nuk është llogaritur Fondi Rezervë.**
- Sipas grafikut te punimeve kohezgjatja e punes do te jete 3 muaj.**



PËRFUNDIM

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin e zbatimit të objektit "NDËRTIM, SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËVE TË BRENDSHME, BASHKIA BELSH" me porositës Bashkinë Belsh konkludohet se: *Projekti është konceptuar drejt, konkluzionet dhe rekomandimet e dhena ne kete oponence te plotesohen para zbatimit të punimeve.*



GRUPI I OPONENCËS

Ing. Konstruktor. Valbona PONDE

Nr.Lic.K.1562/3

Ing. Transp. Besjana MEMOCI

Nr.Lic.K. 2337/1

SHEFE E SEKTORIT TË OPONENCAVE

Ing. Mamica SHEHI

DREJTORE DREJTORIE

Ing.Valbona PONDE

